



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Predatao Received/Deliverty		16-04-2021		viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	1821/2021		1/3	

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.126/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.126/2021 të datës 08.03.2021 të parashtruar nga kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen administrative-juridike „*kërkesë nga marrëdhënia e punës*“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.04.2021,unanimisht mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A. nr. 126/2021 e datës 08.03.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja në pozitën e punës Zyrtare e Arkivit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 08.03.2021 përmes postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 1029/2019 e regjistruar A.16/2021, me pretendimin ankimor që Këshilli të shqyrtoj ankesën për ngritjen e koeficientit të pagës nga shtatë (7), në tetë (8), si dhe kompensimin e koeficientit në mënyrë retroaktive nga data e sistemimit si Zyrtare e Arkives.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesë të ankueses të Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (me tej MKRS), ndërsa Këshilli më datë 29.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosje meritorë të çështjes në ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 126/2021, të datës 08.03.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësim Ankesën me numër protokolli 1351/2012 të datës 24.03.2021, Ankesën e datës 12.01.2021 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të MKRS, E-mail i datës 08.02.2021 lidhur me njoftimin e ankueses për parashtrim të ankesës në KPMSHC; Kërkesë për ngritjen e koeficientit të pagës me numër protokolli 437/2020 të datës 03.02.2020, Vendimi i datës 26.12.2007, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; për sistemimin e ankueses, Vendimi i datës 22.11.2011, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Akt Emërimi i datës 22.06.2012; Përgjigjen në ankesë të datës 29.03.2021, me numër protokolli 450/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar ,sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit me numër 1397/2012 të datës 22.06.2012, Kolegji ka konstatuar se ankuesja ushtron pozitën e Zyrtares së Arkivit, në Departamentin e Administratës Qendrore, pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me koeficient shtatë (7) të pagës.

Kolegji fillimisht ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses _____ e cila pretendon që Këshilli ti njohë të drejtën e ngritjes së koeficientit të pagës nga shtatë (7), në koeficient tetë (8) si dhe të behët kompensimi i diferencës së koeficientit nga data e sistemimit si Zyrtare e Arkivës, pasi që ajo ka vendim të plotfuqishëm për ngritje të koeficientit si dhe për arsye të vëllimit të punove dhe kontributit që ka dhënë në MKRS nga viti 2002.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se : *1.E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil si dhe nenin 9 paragrafi 1 ku është përcaktuar së "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës"* dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se drejta në pagë është e drejtë themelore e nëpunësit civil nga marrëdhënia e punës dhe së nëpunësi civil ka të drejtën e realizimit të pagës bazë të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. E në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në provat e lëndës Kolegji konstaton se ankuesja në Akt Emërtim e saj me numër 1397/2012 të datës 22.06.2012 ka të përcaktuar koeficient shtatë (7) të pagës dhe së e njëjta realizon po koeficient shtatë (7) të pagës.

Ndërsa, përkitazi me pretendimin ankimor për ngritje të koeficientit-gradës së pagës, Kolegji i është referuar nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, më të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për*



financa, Andaj, mbi këtë bazë Kolegji konstaton se çdo ngritje e koeficientit-gradës realizohet në respektim të plotë të këtyre dispozitave ligjore nga ana e organit të punësimit, e si rrjedhojë pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor që ti kompensohet koeficienti në mënyrë retroaktive me arsyetimin se ankuesja ka një Vendim të plotfuqishëm për ngritje të koeficientit të pagës të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë e cila dëshmon një fakt të tillë, përveç Vendimit të datës 22.11.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit i cili referohet pozitës së ankueses si Asistente e Lartë Administrative e jo si Zyrtare e Arkives, andaj pretendimi ankimor mbi këtë bazë po ashtu është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. nr. 126/2021

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMShCK-së

